



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL
MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO	AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT PROTIV KORUPCIE CORRUPTION AGENCY
Dep: DPK DMP	BI-Proj: 03-2384/12
Broj-stranica: 02	Data: 05-07-2012
Nr. pages:	Date:
PRISHTINE	

Nr.regj.42402/11

GJKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Sevdije Gashin duke vendosur sips Aktvendimit të Gjykatës së Lartë për Kundervajtje me nr;103/2012,të dt.26.01.2012, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Shpresa Hasaj-Hyseni nga Prishtina , për kundërvajtje nga neni 4.parg.,1.1 dhe 3 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 1.1. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.**25.06.2012** merrë ketë,

A K T V E N D I M

E PANDEHURA:Shpresa Hasaj-Hyseni e lindur me 01.04.1958 në Pejë,tani jeton në Prishtinë “Lagja e Ulpiana”Rr”Muj Krasniqi”Hyrja e parë,nr.14,e martuar,nenë e 2 fëmijve, e gjendjes së mesme ekonomike,ka të kryer fakultetin,Gjyqtare në Gjykatën komunale në Prishtinë

Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Gjyqtare në Gjykatën Komunale në Prishtinë ,në deklarin e rregullt të pasurisë për vitin 2010,nuk e ka deklarue terë pasurin që e posedon ajo dhe bashkëshorti i saj,pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë e njohtuar se është përfshirë në listen e Zyrtarve,të cilet janë të obliguar ta bejnë deklarin e plotë të pasurisë. Gjatë kontrollit nga Agjencioni Antikorrupcion i janë gjetur dy paluejtëshmeri në emer të bashkëshortit të saj në sipërfaqe prej 4321 m2 dhe 10852m2,të cilat pasuri janë të evidentuara në Zyrën katastrale në Pejë
Me veprim të këtill ka kryer kundervajtje nga neni 4 pika.1.1 dhe 3 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë public me NR.03/L-126 andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **1000 (njëmij) €**, të cilen gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formen e prerë,në dobi të të hyrave gjyqësore të Kosovës,në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.
Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej **30 ditësh** duke ju llogaritur **15 €** në një ditë burgimi.
Shpenzime të procedures nuk ka pasur.Në emer të paushallit gjyqësor e pandehura është i obliguar të paguaj shumë prej **5 EURO**, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.
Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit,kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës
Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurës dhe parashtuesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë,me kërkesën nr.01-4696/11 të parashtuar gjykatës me datën 05.12.2011 për iniciimin e procedures kundërvajtëse kundër të pandehurës së permendur me lartë,si dhe për kundravajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.
Gjykata Komunale për Kundervajtje në Prishtinë duke vepruar sipas kerkesës,e zhvilloj procedurën kundervajtse dhe të pandehurën e shpalli fajtor dhe e denoi me gjobë prej **1000 eurosh**,dhe në emer të paushallit gjyqësor në shumen prej **5 eurosh**.

03-2384/12/02
fuzi

2.

E pandehura Shpresa Hasaj-Hyseni në aftain e parapar ligjor e atakoj Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundervajtje në Prishtinë, me arsyetim se aktvendimi nuk është nxierr në mënyr të drejtë.

Gjykata e Lartë për Kundervajtje me dt.26.01.2012, me Aktvendimin me nr:103/2012, e Abrogon Aktvendimin me nr.Regj:42402/11, lënden ja ktheu Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje dhe e obligon që të ndermerr disa veprime dhe të bënë vertetimin e provave që e pandehura i thekson në ankesë. Duke veprue sipas udhëzimeve të cekura në Aktvendimin GJ.L.nr:103/2012, të dt.26.01.2012, Gjykata komunale për kundervajtje në Prishtinë, thirri parshtruesin e kërkesës që ta benë plotësimin e kërkesës, sipas rekomandimeve të Gjykatës së Lartë.

Parashtruesi i kërkesës me datën 20.03.2012 beri plotësimin e kërkesës, duke theksuar se Shpresa Hyseni me dt.23.03.2012 me nr.portokolli 03-981/11 i ka parqitur disa të dhena në formularn për deklarimin e pasurisë, mirpo gjatë kontrollit të plotë të formularit për deklarimin e pasurisë kemi konstatue se e lartëcekura nuk e ka përmbush obligimin ligjor në pajtim me nenin 4 paragrafi 1.1.1 dhe 3 i sanksionuar me nenin 16 paragrafi 1.1 e ligjit i cili ka qenë në fuqi në kohën e deklarimit.

Gjykata e shkallës së parë me kujdes shqyrtoj vrejtjet dhe rekomandimet e dhenuna nga Gjykata e Lartë sipas Aktvendimit me nr:103/12, të dt.26.01.2012, pastaj ndërmorri të gjitha veprimet procedurale, thirri parshtruesin e kërkesës që ta benë plotësimin e kërkesës, pastaj edhe një herë me një kujdes të madh shqyrtoj kërkesën, plotësim kërkesen, deklaratën e të pandehurës, dhe provat të paraqitura nga institucioni përkatës, shkresat tjera të lëndës, dhe erdhi në përfundim se e pandehura Shpresa Hasaj-Hyseni ka kryer kundervajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundervajtjen të cilen e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasyssh peshen e kundervajtjes, si dhe rrethanat tjera konform nenit 7 të LMK-së

Duke i marrë prasysh të gjitha këto u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit.

Konform nenit 109.al.2 e LMK-së, caktohen shpenzimet e procedureës

Me sa u tha me lartë u vendos sin e dispozitiv te ketij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për Kundervajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDERVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari
Murat Paçarada

